

BASHKIA KUKËS
NJOFTIM DHËNIE ME QIRA

Autoriteti i Dhenies me Qera :

Bashkia Kukes

tel/fax 0242 (2) 5110

Adresa, Nr. Tel - “Sheshi Skenderbej” lagj.Nr.5,

Data e zhvillimit te konkurimit

27.03.2024 ora 10:00

Lloji i Procedurës standarde te konkurimit E Hapur

Objekti i konkurimit publik: Dhenie Me Qera E Siperfaqes se Fondit Pyjor/Kullosor Ne Ekonomine Pyjore Mamez-Kalimash, Parcelat 113/d, 114/a.

Përshkrim i shkurtër i objektit te konkurimit publik : Dhenie me qera te siperfaqes 15 ha te fondit pyjor/kullosor ne ekonomine pyjore mamez-kalimash, parcelat 113/d, 114/a” per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese etj.)

1.Fillimi i procedurave për dhënie me qera me anë të konkurimit publik të siperfaqes 15HA, te llojit shkurre, pjese e pasurise nr.2208 të fondit Pyjor/kullosor publik sipas udhëzimit nr.1,date 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave Dhenie me qera te siperfaqes 15 ha te fondit pyjor/kullosor ne ekonomine pyjore mamez-kalimash parcelat 113/d, 114/a” per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese etj.), me afat përdorimi (qiraje),10(dhjetë) vite (me te drejte rinovimi).

2.Çmimi dysHEME i fillimit të konkurimit është 2.679.600 (dymilion e gjashteqind shtatedhjete e mije e gjashteqind) lekë, në vit dhe për siperfaqen 15 ha, e përlllogaritur kjo sipas VKM Nr.559, date 29.07.2022 “Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” (i ndryshuar).

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia ne përdorim të përkohshëm të sipërfaqes se fondit pyjor/kullosor per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese etj.), me afat përdorimi (qiraje),10(dhjetë) vite (me te drejte rinovimi).

4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve te konkurimit për subjektet që konkurojne do të jenë :

Nr . Lloji i Kriterit Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues(e shprehur në pikë)

Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtro-het, i cili përmban hartën topografike me koordi-natat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;

b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;

c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;

d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;

e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

5.Dokumentacioni që duhet të plotesohet nga konkurrentët për konkurrim është: sipas udhëzimit nr.1,date 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave Për Dhënie Në Përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kullosor Publik”

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a)kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;

b)ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;

- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim ne proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
- Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Adresa, Bashkia Kukës, Zyra “Salla e Mbledhjeve” Nr. Tel - “Sheshi Skenderbej” lagj. Nr. 5, tel/fax 0242 (2) 5110

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 27.03.2024 ora 10:00

9. Informacion mbi dokumentet e konkurimit publik:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen pranë autoritetit të dhenies me qera

Dokumente me pagesë:

Po Jo

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi 1500

Dokumentet standarde të ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbal/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit .